



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.490/ 2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryesues, Ymer Hoxha, dhe Adnan Konushevc, anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi për ankesën e Oliver Ivanoviq, kryetar i subjektit politik GI SDP, me seli në Mitrovicë paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë për shkak të Shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Oliver Ivanoviq kryetar i subjekti politik GI SDP, me seli në Mitrovicë, paraqitur ndaj subjektit politike Lista Serbe, me seli në Mitrovicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP, më datë 24.10.2017 ka pranuar një ankesë nga kryetari i subjektit politik GI SDP Oliver Ivanoviq të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 21.10.2017, të parashtruar ndaj subjektit politik Lista Serbe me të cilën pretendon se aktivistët e Listës Serbe disa herë i kanë dëmtuar posterat plakatat, grafitet të subjektit të tyre politik në Mitrovicën e Veriut, po ashtu siç thekson ai më datën 19 dhe 20 tetor iu është bërë mbulimi i posterava prej aktivistëve të subjektit në fjalë. Parashtruesi i ankesës pretendon se nga subjekti politik Lista Serbe është bërë transmetimi dhe emitimi i spotit negative në televizionin TV Most, nga Zveqan, në periudhën prej 16.10.2017 deri më 20.10.2017, me të cilën është përhapur urrejtja ndaj kandidatit për kryetar komune, Oliver Ivanoviq. Me këto veprime sipas parashtruesit të ankesës paraqesin shkelje të nenit 4 të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 .

Ankesës iu kanë bashkangjitur disa fotografi lidhur me pretendimet e tij ankimore.

Subjekti Politik Lista Serbe në përgjigjen e tyre theksojnë se ankesa e paraqitur nga GI SDP Oliver Ivanoviq është parashtruar jashtë afatit ligjor prej 72 orëve siç parashihet me nenin 5 e Rregullave dhe Procedura e PZAP-it Nr.02/2015, sepse ankesa është parashtruar më datë 24.10.2017 ndërsa në ankesa potencohet se shkelja ka ndodhur me 19 dhe 20 tetor 2017. Më tej shtojnë se në fotografitë e bashkangjitura në ankesë nuk paraqesin kurrfarë dëshmie materiale lidhur me veprimtarinë e subjektit të tyre politik dhe kjo mund të jetë edhe vet denoncim sepse në bazë të një ankese të tillë gjoha mund ti shqiptohet vetëm subjektit politik

i cili të njëjtën e ka parashtruar sepse nga fotografitë e bashkangjitura mund të shihet se subjekti politik GI.SDP ka vendosur materialet propaganduese në vendet publike në kundërshtim me ligjin. Së fundi theksojnë se në Komunën e Mitrovicës janë regjistruar një numër i madh i listave zgjedhore dhe se subjekti politik GI SDP është në armiqësi gati me të gjitha listat zgjedhore dhe është e mundur që këto postera dhe materiale GI SDP ti kenë dëmtuar edhe subjektet tjera, por ne mbetemi pran pretendimit se këto dëmtime të posterave janë bërë nga ndërmarrjet higjienike teknike sepse posterat kanë qenë të vendosur në hapësira publike. Kërkojnë nga PZAP- që ta hedhin poshtë si të pas afatshme ankesën.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet në ankesën e parashtruar, në kuptim të nenit 117 par 3 të LZP-së ku është përcaktuar: *“se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*. Paneli gjatë vendosjes së ankesës i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë dhe kurë vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë mirë të bazuara në fakte dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore ankesat e tilla i refuzon.

Paneli vlerësoj se ankesa e parashtruar nga parashtruesi i ankesës nuk i plotësojë këto standarde ligjore. Kjo për faktin se pala ankuese nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për tu vërtetuar ajo për të cilin pretendohet me ankese, andaj paneli vendosi ta refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr. 490/2017 më datën 25.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa.